



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GRAMSH  
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr \_\_\_\_\_ prot

Gramsh, më 13/08/2019

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

Data 13.08.2019

Për: BOE - "Al-Mexwood" sh.p.k & "Bajrami-N" sh.p.k

Adresa: NJA Pishaj, pasuria 6/76, pranë uzinës, Çekin", Gramsh & Labinot Fushë, Xibrakë, km.13, nr.pasurisë 734/1+732+738/9, Elbasan

Procedura e prokurimit: "Procedurë e hapur", me mjete elektronike

Numri i referencës së procedurës/lotit: . REF-20693-05-06-2019

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Rikonstruksion i kanalit ujitës Galigat-Cingar Sipër -Drizë", me afat 90 ditë nga data e lidhjes së kontratës.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike 13/05/ 2019 [Nr. 19]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X**, oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

\* \* \*

1. **BOE - "Al-Mexwood" sh.p.k & "Bajrami-N" sh.p.k** me nr.Nipti K36603807B & K02727202O me vlerë të ofertës 27 202 221 (njëzetë e shtatë milionë e dyqind e dymijë e dyqind e njëzetë e një) lekë, pa TVSH.
2. **Shoqëria - "Isobar Construction" sh.p.k** me nr.Nipti L12210036D me vlerë të ofertës (nuk ka dorëzuar ofertë).
3. **Shoqëria - "Leon Konstruksion" sh.p.k** me nr.Nipti K71820009I me vlerë të ofertës 21 875 140 (njëzetë e një milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e njëqind e dyzetë) lekë, pa TVSH
4. **Shoqëria - "Nika" sh.p.k** me nr.Nipti J76705047U me vlerë të ofertës 17 666 200 (shtatëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind) lekë, pa TVSH
5. **Shoqëria - "Shëndelli" sh.p.k** me nr.Nipti K07924803N me vlerë të ofertës 23 650 877 (njëzetë e tre milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë lekë, pa TVSH

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm :

1. Operatori ekonomik - "Isobar Construction" sh.p.k, për arsyet :

Nga ana e Komisionit të Vleresimit të Ofertave konstatohet se ky OE **nuk** ka dorëzuar asnjë dokument lidhur me kualifikimin tekniko-ligjor si dhe nuk ka dorëzuar oferte .

2. Operatori ekonomik - "Leon Konstruksion" sh.p.k, për arsyet :

Nga ana e Komisionit të Vleresimit të Ofertave konstatohet se ky OE **nuk** ka dorëzuar ne SPE gjithë dokumentacionin lidhur me kualifikimin tekniko-ligjor të kërkuar ne Kriteret e Pergjithshme dhe të Vecanta të Kualifikimit të pershkruara ne DST, konkretisht:

- Vërtetimi nr.1662 prot datë 18.04.2018 lëshuar nga bashkia Korçë ,parashikon shlyerjen e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore deri më datë 31.05.2018 dhe nuk parashikon shlyerjen e tyre për gjithë vitin 2018 sic parashikohet në pikën 2.2.3 të kriterëve të vecanta të kualifikimit.
- Vërtetimi nr.4331/1 prot datë 18.04.2018 lëshuar nga bashkia Lushnjë ,parashikon shlyerjen e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore deri më datë 18.04.2018 dhe nuk parashikon shlyerjen e tyre për gjithë vitin 2018 sic parashikohet në pikën 2.2.3 të kriterëve të vecanta të kualifikimit
- Vërtetimi datë 17.05.2018 lëshuar nga bashkia Berat ,parashikon shlyerjen e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore deri më datë 17.05.2018 dhe nuk parashikon shlyerjen e tyre për gjithë vitin 2018 sic parashikohet në pikën 2.2.3 të kriterëve të vecanta të kualifikimit
- Nuk ka dorëzuar listë pagesat për 6-muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit ,me qëllim të provojë nr.mesatar të punonjësve të kërkuar ,stafit teknik,teknikët e ndërtimit, si dhe punonjësit e specializuar nëse figurojnë ose jo në listë pagesat e punonjësve 6-muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit.Ka dorëzuar listë pagesat vetëm për periudhën janar-maj 2019 në kundërshtim këto me pikat 4,5,7,10 të kriterëve të vecanta të kualifikimit
- Nuk përmbush kriterin për dy punonjës montatorë me dëshmi kualifikimi në kundërshtim me pikën 2.3.10 të kriterëve të vecanta të kualifikimit.Është dorëzuar dokumentacion për një punonjës H.Xh por nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se dëshmia e kualifikimit të sigurimit teknik është lëshuar për saldator dhe jo montator,si dhe per E.M por nga verifikimi i dëshmisë së kualifikimit dhe IQT-së rezulton hidraulik.
- Kontrata e furnizimit datë 12.07.2019 për bimë e shkurre dekorative nuk është noteriale e si e tillë nuk ka vlerë ligjore duke mos përmbushur kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.20 të kriterëve të vecanta të kualifikimit
- Kontrata e shërbimit datë 12.07.2019 për depozitimin e mbetjeve jo të rrezikshme lidhur ndërmjet “Leon Konstruksioin “ shpk dhe “Llazo” shpk nuk është noteriale e si e tillë nuk ka vlerë ligjore,si dhe vendndodhja e vendpozitimit të mbetjeve sipas lejes mjedisore nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.1.A “StacionTransferimi per mbetjet jo te rrezikshme” është në Bishqethëm,Lushnjë ,më e madhe se 30 km nga objekti i prokurimit , në kundërshtim me pikën 2.3 19. të kriterëve të vecanta të kualifikimit.
- Për autopompën e betonit nuk është dorëzuar certifikata për transport mallrash në kundërshtim me pikën 2.3 21/a. të kriterëve të vecanta të kualifikimit

### 3. Operatori ekonomik - “ Nika ”sh.p.k,për arsytet :

Nga ana e Komisionit të Vleresimit të Ofertave konstatohet se ky OE **nuk** ka dorëzuar ne SPE gjithë dokumentacionin lidhur me kualifikimin tekniko-ligjor të kërkuar ne Kriteret e Pergjithshme dhe të Vecanta të Kualifikimit të pershkruara ne DST, konkretisht:

- Vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike date 25.04.2019 nuk perfshin detyrimet e maturuara të energjisë elektrike për muajin maj 2019 në kundërshtim me nenin 26/7/c të VKM-se nr. Nr.914 dt 29.12.2014 “Për Rregullat e Prokurimit Publik” në të cilin thuhet se ” Për të provuar përmbushjen e kriterit për kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: Për të provuar përmbushjen e kriterit për kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon:c)një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori

*ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë.*

- Ka detyrime të pashlyera ndaj bashkise Gramsh në masën 1 373 607 lekë si dëm ekonomik i lënë këtij subjekti nga ana e KLSH-së në raportin Përfundimtar të Auditimit të vitit 2017, sipas informacionit të Drejtorise Ekonomike për të cilat është vënë në dijeni zyrtarisht në mënyrë të herëpashërshme. Bazuar në rekomandimin e APP-se nr.3341/1 datë 20.03.2018 “Në disa procedurë prokurimi, autoritetet kontraktore, kryesisht Bashki, kanë kërkuar që operatori ekonomik të paraqesë një vërtetim se, nuk ka detyrime ndaj vetë autoritetit kontraktor si: taksat vendore, gjokat e ndryshme nga autoritet audituese legjitime, si dhe çdo lloj detyrimi tjetër të parashikuar në legjislacionin në fuqi. Për sa kohë që autoriteti kontraktor e disponon këtë informacion, ky kriter nuk është i nevojshëm të vendoset”.
- Nuk ka dorëzuar dokumentacion për dy montatorë në kundërshtim me pikën pikën 2.3 13. të kriterëve të vecanta të kualifikimit.
- Nuk ka dorëzuar dokumentacion për një agronom në kundërshtim me pikën pikën 2.3 8. të kriterëve të vecanta të kualifikimit.
- Për një nga teknikat e ndertimit nuk është dorëzuar diplomë, librezë pune, Cv në kundërshtim me pikën pikën 2.3 7. të kriterëve të vecanta të kualifikimit.
- Punonjësi karpentier nuk figuron në listepagat e shoqërisë të dorëzuara për muajin prill 2019 në kundërshtim me pikën pikën 2.3 10. të kriterëve të vecanta të kualifikimit.
- Nuk ka dorëzuar analizën e cmimeve teknike në kundërshtim me pikën pikën g. të kriterëve të vecanta të kualifikimit.
- Kontrata e furnizimit datë 18.05.2017 për furnizim me binder dhe asfalt është lidhur vetëm për furnizime brenda territorit administrativ të bashkive Pogradec dhe Korçë.
- Nuk ka dorëzuar liçencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B “Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e mbetjeve Urbane” në kundërshtim me pikën 2.3.18 të kriterëve të vecanta të kualifikimit.
- Nuk ka dorëzuar leje mjedisore nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.1.A “Stacion Transferimi për mbetjet jo të rrezikshme” apo kontratë për depozitim të mbetjeve jo të rrezikshme me një subjekt të licensuar 30 km larg objektit të prokurimit, në kundërshtim me pikën 2.3 19. të kriterëve të vecanta të kualifikimit.
- Operatori ekonomik nuk ka paraqitur kontratë furnizimi për pemët dhe shkurret me një subjekt të licensuar nga QKL shoqëruar me vedeklarimin se prodhuesi është konform sistemeve të menaxhimit të cilësive në kundërshtim me pikën 2.3 20. të kriterëve të vecanta të kualifikimit.
- Në preventivin e punimeve është hequr zëri “Makineri dhe pajisje pajisje” në kundërshtim me pikën 2.3 Seksioni 2 të DST-së “Ofertuesi duhet të shënojë në preventiv çmimet për çdo zë punimi dhe çmimin total të ofertës të të gjitha punëve, pa TVSH. Vlera e TVSH-se, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të ofertës”.
- Gjithashtu ky operator ekonomik ka bërë ndryshime në përshkrimin e sasive të punimeve të preventivit të ofertës, të cilat ishin të specifikuar nga autoriteti kontraktor duke mos paraqitur ofertën sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Këto ndryshime bien ndesh me ligjin “Për Prokurimin Publik”, neni 53 ku lejohen vetëm korrigjime për gabime aritmetike dhe jo ndryshime që prekin thelbin e punimeve. Konkretisht: zëri i punimeve me nr. rendor 6 dhe nr. analize 3.243/1, është kërkuar nga AK në një sasi 1037 m<sup>3</sup> (Veshje me beton C 16/20 t=10 cm i kanalit), ndërkohë që ky OE ka ofruar sasinë prej 995 m<sup>3</sup>.

#### 4. Operatori ekonomik - “Shëndelli” sh.p.k. për arsyet:

Nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave konstatohet se ky OE **nuk** ka dorëzuar ne SPE gjithë dokumentacionin lidhur me kualifikimin tekniko-ligjor të kërkuar në Kriteret e Përgjithshme dhe të Vecanta të Kualifikimit të përkrahura në DST, konkretisht:

- Nuk përmbush kriterin për 2 montatorë pasi nuk ka dorëzuar dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik për montator, në kundërshtim me pikën 2.3 10. të kriterëve të vecanta të kualifikimit
- Nuk plotëson kriterin për 1 (një) Agronom pasi nuk figuron në listpagesat e shoqërisë në kundërshtim me pikën 2.3 8. të kriterëve të vecanta të kualifikimit.
- Nuk ka pasqyruar në shtojcën 10 "Mbi disponimin e makinerive" si dhe nuk ka dorëzuar dokumentacion për një autopompë betoni në kundërshtim me pikën 2.3.21 të kriterëve të vecanta të kualifikimit.
- Operatori ekonomik nuk ka paraqitur kontratë furnizimi për pemët dhe shkurret me një subjekt të licensuar nga QKL shoqëruar me vedeklarimin se prodhuesi është konform sistemeve të menaxhimit të cilësive në kundërshtim me pikën 2.3 20. të kriterëve të vecanta të kualifikimit
- Ing. mjedisit S.J pjesë e stafit teknik e cila është deklaruar si një nga drejtuesit teknikë që do të jenë të pranishëm në objekt nuk figuron të jetë e përfshirë në listë pagesat e shoqërisë 6-muajt e fundit, në kundërshtim me pikën 2.3 5. të kriterëve të vecanta të kualifikimit
- Në pikën 2.3.5 të Kriterëve të vecanta të kualifikimit është kërkuar *"Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, libere pune, Cv si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit stafi inxhinierik si më poshtë:*

*1 (një) inxhinier Ndërtimi*

*1 (një) inxhinier Topograf*

*1 (një) inxhinier Mjedisit*

*1 (një) inxhinier Mekanik*

*Nje nga inxhinieret e mesiperme te jete i pajisur me certificate lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedisit*

Nga dokumentacioni i dorëzuar konstatohet se nga inxhinieret e mesiperme, ing. mjedisit S.T është e pajisur me certificate për vlerësimin në mjedis por në deklaratën e operatorit ekonomik 'Deklaratë për stafin', nuk është deklaruar si drejtuese teknike që do të ndjekë punimet në objekt, e si rrjedhojë kriteri për 1 ing. mjedisit konsiderohet i papërmbushur.

- Drejtuesja teknike ing. ndërtimi V.T e deklaruar (e vetmja ing. ndërtimit e deklaruar) në shtojcën 'Deklaratë për stafin' si një nga drejtuesit teknikë që do të jenë të pranishëm në objekt, figuron të jetë e punësuar edhe në një shoqëri tjetër me nr. nipti J71826005F me objekt veprimtarie "Mbikqyrje e kolaudim të të gjitha punimeve të zbatimit në fushën e ndërtimit e infrastruktures ndërtimore" në kundërshtim me kreun IV pika 2 të VKM-së nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar.
- Vendndodhja e vendpozitimit të mbetjeve, Leje mjedisore nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.1.A "Stacion Transferimi për mbetjet jo të rrezikshme" është më e madhe se 30 km nga objekti i prokurimit, në kundërshtim me pikën 2.3 19. të kriterëve të vecanta të kualifikimit
- Ky operator ekonomik ka bërë ndryshime në përshkrimin e sasive të punimeve të preventivit të ofertës, të cilat ishin të specifikuar nga autoriteti kontraktor duke mos paraqitur ofertën sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Këto ndryshime bien ndesh me ligjin "Për Prokurimin Publik", neni 53 ku lejohen vetëm korrigjime për gabime aritmetike dhe jo ndryshime që prekin thelbin e punimeve. Konkretisht: zeri i punimeve

me nr. rendor 6 dhe nr analize 3.243/1 , eshte kerkuar nga AK ne nje sasi 1037 m<sup>3</sup> (Veshje me beton C 16/20 t=10 cm i kanalit) , nderkohe qe ky OE ka ofruar sasine prej 995 m<sup>3</sup>

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, **informojmë BOE - “Al-Mexwood ”sh.p.k & “Bajrami-N “ sh.p.k**, me adresë NJA Pishaj,pasuria 6/76,pranë uzinës, Çekin ”,Gramsh & Labinot Fushë ,Xibrakë ,km.13,nr.pasurisë 734/1+732+738/9 , Elbasan , se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **27 202 221 (njëzetë e shtatë milionë e dyqind e dymijë e dyqind e njëzetë e një) lekë,pa TVSH**, pikët totale të marra [\_\_\_\_],është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkisë Gramsh**, Bulevardi “10 korriku”,Sheshi “Kamber Dërmyshi “ ,pranë Njesisë së Prokurimit,kati tretë, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [\_\_\_\_], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 02.08.2019.

**Ankesa:** Nuk ka pasur ankesa

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**KRYETARI  
KLODIAN TAÇE**

Konceptoi E.Guzi

Miratoi E.Guzi

Dosja nr \_\_\_\_\_

Afati \_\_\_\_\_